

PKR.nr.103/15

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA**, si gjykatë e shkallës së parë penale, me gjyqtarin Musa Konxheli, si dhe bashkëpunëtoren profesionale Mirlinda Bytyqi Rexhepi, në çështjen penale kundër të pandehurit K.G., për shkak të veprës penale përdorimi i armës apo i mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.I.nr.229/13 te datës 04.05.2015, në praninë e përfaqësuesit të akuzës-prokurorit të shtetit Florije Salihu Shamolli, të pandehurit K.G., pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar më dt.09.08.2016, morri dhe publikisht shpalli këtë :

**A K T G J Y K I M**

I akuzuari **K.G.**, nga fsh....., Komuna e Ferizajt data e lindjes....., në Prishtinë, nga i ati H., e ëma R. e gjinisë Q., shqiptar, shtetas i R. së Kosovës, bujk, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike,

**ËSHTË FAJTOR**

me dt. 01 nëntor 2013, rreth orës 22:00 në fsh.Mirash, Komuna e Ferizajt, ka përdorur armën në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm mbi armët, në atë mënyrë që ka shtënë disa herë në ajër me armën automatike të markës AK 47, me numër serik 2008195, të cilën e mbante me autorizim, ku me rastin e kontrollit të shtëpisë së tij nga ana e policisë i është gjetur arma dhe një karikator i zbrazur, të cilat i sekuestrohen nga policia

**-me këtë ka kryer veprën përdorim i armëve apo i mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.1 të KPRK-së.**

Andaj gjykata në bazë të dispozitave të përmendura dhe nenit 3,6, 17,21,41,43,45,46, dhe 73 të KPK-së si dhe nenin 365 dhe 359 të KPRK –së të pandehurin e :

## **G J Y K O N**

**Denim burgimi në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj** i cili conform nen. 47 par. 1 të KPK-së me pëlqimin e të pandehurit, dënimi me burg i zavendësohet në **dënim me gjobë në lartësi prej 1000 € (njëmijë euro)** të cilën detyrohet që ta paguaj në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmerisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përbarimit me dhunë.

Me kërkesën e të pandehurit dënimi me gjobë mund të paguhet edhe me këste mujore dhe atë jo me pak se 3 këste mujore dhe jo me shume se 6 kë+ste mujore nga plotëfuqishmeria e këtij aktgjykimi.

Konform nenit 375 par. 3 të KPRK-së, konfiskohet në mënyrë të përhershme arma automatike AK-47 me numer 2008159, si dhe një karikator I zbrazur.

Në bazë të nen. 450 par.1 dhe par.2 të KPPK-së, obligohet I pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 € në afat prej 15 ditëve nga dita e plotëfuqishmerisë së këtij aktgjykimi

## **A r s y e t i m i**

Prokuroria Themelore në Ferizaj-Departamenti për Krime të Rënda, me aktakuzën PP.I.229/13 të datës 04.05.2015 ka ngarkuar të pandehurin K.G., për vepren penale mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të pa autorizuar të armëve nga neni 375 par.1 të KPRK-së

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datë 09.08.2016, në të cilën përfaqësuesi i akuzës prokurori i shtetit Florije Salihu Shamolli , mbeti në tërsi pranë aktakuzës duke i propozuar gjykatës që i pandehuri të shpallet fajtorë dhe ti shqiptohet një dënim i paraparë me ligj.

I pandehuri K.G. në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale, për të cilën e ngarkon aktakuza, në të gjitha pikat e saj dhe shton se është penduar thellë për këtë vepër penale dhe premtion se nuk dot ë kryej vepra të tilla apo të ngjashme.

Kryetari i trupit gjykues konstaton se janë plotësuar kriteret nga nen. 248 par.1 të KPPK-së nga se:

- i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë,
- pranimi i fajit bëhet vullnetarisht nga i pandehuri,
- pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materiale e prezantuar nga prokurori i shtetit si dhe në provat tjera që gjenden në shkresat e lëndës, vërtetimi mbi konfiskimin e përkohshëm te sendeve i dt. 20.11.2013 si dhe shikimi i fotografive që gjinden në shkresat e lëndës
- aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Meqenëse i pandehuri e ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përcaktuara me nenin 248 par.1 të KPPK-së, kryetari i trupit gjykues konform nenit 248 par.4 të KPPK-së ka vazhduar me shqiptimin e dënimit ( *nëse i pandehuri në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë dhe kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësorë, lidhur me këtë shih mendimin juridik të Gjykatës Supreme të evidentuar si GJA.nr.207/13 të dt.19.03.2013*)

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit formësohen tiparet e veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytësim të pa autorizuar të armëve nga neni 375 par.1 të KPRK-së.

Konform nenit 375 par. 3 të KPRK-së, konfiskohet në mënyrë të përhershme arma automatike AK-47 me numer 2008159, si dhe një karikator I zbratur

Konformë nen. 450 par.2 pika 6 të KPPK-së obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 (tridhjetë) euro, e cila është caktuar duke pasur parasyshë gjendjen ekonomike të pandehurit dhe komplikushmerinë e kësaj çështje penale. Nga arsyet e sipërcekura është vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-DEPARTAMENTI PER KRIME TE RENDA,  
PKR.nr.103/15 e dt.09.08.2016**

**Bashkëpunëtorja profesionale**  
Mirlinda Bytyqi Rexhepi

**Kryetari i trupit gjykues,**  
Musa Konxheli

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi, lejohet ankesa në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykates së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.